



Pranuar / Dorezuar / Prilijeno / Prudato / Received / Delivered	17.12.2021	1	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jednica / Org / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKOMSHCK	6223/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.920/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani - kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti anëtar dhe Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 11.11.2021 me numër A.nr.1920/2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: “Shukrije Obërtinca” Objekti 19 Nr.41 Komuna Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankesa me numër A.nr.920/2021 e datës 11.11.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë së Punëve të Jashtme dhe Diasporë, në pozitën “Zyrtar i Lartë për këshillin Evropian dhe Evropën Perëndimore”, me datë 11.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër kërkesës për raportim ditor të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 22.11.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe vendosjes në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 11.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër prot:5402/2021; E-mailin e datës 11.11.2021; E-mailin e datës 07.06.2021 dërguar nga Zyra e Sekretarit të përgjithshëm për stafin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Formularin e Përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.11.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.11.2021; Vendimin e datës



09.12.2020 me numër:232/2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin e datës 01.10.2020 me numër:176/2020 i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit me Nr-96/2016 i datës 04.03.2016; ; Ndryshimi dhe plotësimi i Akt emërimit i datës 28.02.2014; Akt emërimit e datës 18.10.2013; Akt emërimit e datës 19.10.2012; Vendimin e datës 18.04.2014 me Nr.34/14; Vendimin e datës 13.09.2016 me numër:377/2016; Vendimin e datës 24.07.2018 më numër ref:675/2018; Vendimin e datës 13.09.2016 me numër ref:377/2016; Vendimin e datës 10.07.2020 me numër ref:338/2020; Vendimin e datës 14.02.2019 me numër ref:82/2019; Plotësim ndryshim i Vendimit të datës 14.02.2019 me numër ref:82/2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se në bazë të përshkrimit të detyrave për vendin e punës që mban i njëjti obligohet t'i raportojë vetëm Udhëheqësit të Departamentit në baza javore, ndërsa kërkon që të shfuqizohet detyrimi për raportim ditor nga ana e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 07.11.2021 nëpërmjet e-maili u ka dërguar njoftimin për raportim të aktiviteteve të punës në baza ditore jo vetëm ankuesit, por komplet stafit duke përfshi zyrtarët, Udhëheqësve të Divizioneve, Drejtorëve të Departamenteve dhe Drejtorit të Përgjithshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku përcaktohet se: 2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: "2.1. *Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme;* 2.2. *Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të;* 2.3. *Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të;* dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë*", nga rrjedh se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në kuadër të institucionit respektivisht Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në këtë rast është pozita më e lartë në Shërbimin Civil.

Andaj, mbi këtë bazë Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë e zyrtarit më të lartë administrativ në pajtueshmëri me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore që ka, me qëllim të mbarëvajtjes dhe përmbushjes së detyrave zyrtare që ka si objektivi institucioni, në çdo kohë mund të kërkojë nga secili zyrtar, udhëheqës apo drejtorë raport ndërlidhur me përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive që ka gjithë secili, ndërsa secili zyrtar në këtë rast edhe ankuesi duhet ta ketë parasysh obligimet që rrjedhin nga neni 26 paragrafi 1 i Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit" si dhe nenin 28 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij", andaj me këtë rast Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar, ndërsa vlerëson se kërkesa e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm e datës 07.11.2021 ndërlidhur me raportin ditor sa i përket detyrave dhe përgjegjësive që rrjedhin nga marrëdhënia e tyre e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është kërkesë e bazuar.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamentin Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.920/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Arben Çollaku;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.

